



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.34

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.4826, datë 11.4.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	1101
Vendim i GJL nr.4, datë 1.2.2006	Me objekt detyrimin për pagimin e qirasë, prej 800 (tetëqind) USD, në muaj, për periudhën 22.6.2001-30.5.2002.....	1102
Vendim i AMS nr.7, datë 21.3.2006	Për mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike e matematike të shoqërive të sigurimit.....	1106
Vendim i AMS nr.8, datë 21.3.2006	Për miratimin e udhëzimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.1, datë 22.12.2004 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit””.....	1108
Udhëzim i AMS nr.1, datë 21.3.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.1, datë 22.12.2004 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”.....	1108
Vendim i ERE-s nr.24, datë 12.4.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit	1122
Vendim i ERE-s nr.25, datë 12.4.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit	1122
Vendim i ERE-s nr.26 , datë 12.4.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit	1123

DEKRET
Nr.4826, datë 11.4.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Nevjana Halil Kaluza (Kokomani) | 23. Angie Rhea Ralf Thanasi |
| 2. Donika Sotir Odza (Paluka) | 24. Bukuriye Qamil Limani (Kronaj) |
| 3. Jona Emin Odza | 25. Ervisa Rrustem Limani |
| 4. Nesti Niko Stefanllari | 26. Arben Sherif Çekrezi |
| 5. Agron Gjergj Çobani | 27. Artur Demir Ametlli |
| 6. Sulejman Faik Gurmani | 28. Elisa Artur Ametlli |
| 7. Kujtim Zalo Naska | 29. Anida Hasan Ametlli (Hoxha) |
| 8. Madonna Kujtim Naska | 30. Oran Hasan Keqi |
| 9. Aaron Kujtim Naska | 31. Ilda Pellumb Demishaga |
| 10. Blondi Kujtim Naska | 32. Ylli Xheladin Kodra |
| 11. Elira Sulejman Wallinger (Toska) | 33. Matias Ylli Kodra |
| 12. Salike Damin Binder (Mehmeti) | 34. Katharina Ylli Kodra |
| 13. Mondi Bendi Refugjati | 35. Vijosa Fiqiri Kodra (Gega) |
| 14. Zhaneta Haxhi Novruzaj (Bakiri) | 36. Albana Ylli Kodra |
| 15. Mikel Miftar Dino | 37. Marsela Agim Vonthron (Halluni) |
| 16. Stefan Zenel Balliu | 38. Mirela Shpëtim Krasniqi (Rexha) |
| 17. Arbër Stefan Balliu | 39. Feriz Agron Krasniqi |
| 18. Margita Petrit Balliu (Kollaku) | 40. Diana Ramazan Ademi |
| 19. Ina Stefan Balliu | 41. Regino Rudi Kujtim Kolgjini |
| 20. Fisnik Fatmir Lang (Çaku) | 42. Shefkie Brahim Valbona |
| 21. Jonida Koço Goreja (Anastasi) | 43. Elena Robert Bellova (Ndrenika) |
| 22. Enkelejda Thoma Thanasi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.4, datë 1.2.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Nikoleta Kita	Anëtar
Kristaq Ngjela	"
Evjeni Sinoimeri	"
Irma Bala	"
Shpresa Beçaj	"
Ylvi Myrtja	"
Agron A.Lamaj	"
Perikli Zaharia	"
Artan Hoxha	"
Besnik Imeraj	"
Ardian Dvorani	"
Spiro Spiro	"

në seancën gjyqësore të datës 1.2.2006, morën në shqyrtim çështjen civile me palë:

PADITËS I KUNDËRPADITUR: Naim Elezi, i biri i Safetit, i datëlindjes 1958, banues në Tiranë.

I PADITUR KUNDËRPADITËS: Shoqëria tregtare "MASGLASS",-sh.p.k., me seli në Tiranë.

OBJEKTI I PADISË: Detyrimi për pagimin e qirasë, prej 800 (tetëqind) \$ USD, në muaj; për periudhën 22.6.2001 - 30.5.2002.

BAZA LIGJORE: Nenet 801 e vijues të Kodit Civil.

OBJEKTI I KUNDËRPADISË: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së qirasë, lidhur midis palëve më datë 22.6.2001.

BAZA LIGJORE: Nenet 92/"ç", i Kodit Civil dhe 160, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1896, datë 2.5.2003, vendosi:

1. Pushimin e gjykimit për padinë e ngritur nga paditësi/i kundërpaditur Naim Elezi kundër të paditurit/kundërpaditës "MASGLASS", - sh.p.k.

2. Pranimin e kundërpadisë të ngritur nga i padituri/kundërpaditës "MASGLASS", - sh.p.k. kundër paditësit/të kundërpaditur Naim Elezi.

3. Konstatimin, si absolutisht të pavlefshëm, të veprimit juridik të kontratës së qirasë datë 22.6.2001, të lidhur midis palëve të mësipërme, për objektin magazinë, me sipërfaqe 310 m², e ndodhur në rrugën e "Kavajës", tek ish-kombinati "M.Mame".

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.718, datë 4.6.2004, vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër të dy vendimeve ka paraqitur rekurs, në Gjykatën e Lartë, paditësi/i kundërpaditur me të cilin kërkon prishjen e tyre dhe dërgimin e çështjes, për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke parashtruar:

1) Të dy gjykatat kanë bërë shkelje procedurale, pasi kanë lejuar zhvillimin e gjykimit në mungesën time dhe pa më dëgjuar deri në fund të procesit. Kjo shkelje është, në të njëjtën kohë, edhe shkelje si procedurale (nenet 4 e 16 të Kodit të Procedurës Civile) ashtu edhe Kushtetuese (neni 42 i Kushtetutës).

2) Kundërpadia është bazuar në deklaratimet e tre personave që s'janë as me banim, as me punë në Tiranë dhe që janë sjellë të shoqëruar me policë, mënyrë kjo që parashikohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe jo nga Kodi i Procedurës Civile.

Me vendimin datë 14.1.2005, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në Dhomën e Këshillimit), vendosi kalimin e çështjes për gjykim.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 14.7.2005, vendosi kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara, për unifikimin e praktikës gjyqësore, për sa vijon:

1. Kur pushohet gjykimi i padisë, gjykimi i kundërpadisë do të ndjekë të njëjtin fat, apo pavarësisht nga kjo, ajo do të gjykohet si një padi e veçantë ?

2. Rezulton se paditësi është larguar nga salla e gjykimit për prishje të rregullit dhe më pas, përfaqësuesja e tij ka lënë, me vullnet, seancën gjyqësore, pa deklaruar nëse ka hequr dorë nga padia e ngritur nga i përfaqësuari prej saj. Kolegji çmon të drejtë faktin se mosparaqitja ose largimi pa shkaqe të arsyeshme i paditësit nga seanca gjyqësore konsiderohet heqje dorë nga gjykimi i padisë (në rastin në gjykim largimin pa shkaqe të arsyeshme nuk e ka bërë paditësi, por përfaqësuesja e tij).

Bazuar në këtë disponim të vullnetit nga pala paditëse, si dhe faktin se përfaqësuesja e paditësit, në rrethanat e parashtruara më sipër, është larguar nga gjykimi, kjo duhej konsideruar si heqje dorë nga gjykimi i padisë, apo, në këto rrethana, gjykata duhej të sigurohej më parë lidhur me vullnetin e paditësit, duke e thirrur atë në seancën pasardhëse ?

3. Edhe pse gjykata ka marrë vendim për ta shqyrtuar çështjen në mungesë, lind pyetja se, a duhet njoftuar pala paditëse e k/paditur për shqyrtimin e kundërpadisë?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionet e gjyqtarëve Spiro Spiro e Perikli Zaharia dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Se, nga shqyrtimi i akteve të dosjes civile që i përket palëve: Paditës - i k/paditur Naim Elezi dhe i paditur - k/paditës - Shoqëria tregtare "MASGLASS",-sh.p.k., si dhe gjatë seancës dëgjimore në Kolegjet e Bashkuara, rezultoi se: Më 25.10.2002, shtetasi Naim Elezi, ka paraqitur, në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, kërkesëpadi me të cilën kërkon detyrimin e shoqërisë tregtare "MASGLASS",-sh.p.k. që t'i paguajë qiranë, prej 800 (tetëqind) \$ USD në muaj, për periudhën 22 qershor 2001 deri 30 maj 2002, për objektin magazinë, me sipërfaqe 310 m² që ndodhet në mjediset e ish-kombinatit "M.Mame", Tiranë. Mbas tre seancave gjyqësore që u zhvilluan për gjykimin e saj (në datat 18/11, 27/11 dhe 16.12.2002), në seancën e datës 17.1.2003, bazuar në nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile, i padituri paraqiti kundërpadi, me anë të së cilës, bazuar në nenin 92/ç të Kodit të Procedurës Civile, kërkon të konstatohet pavlefshmëria absolute e kontratës së qirasë lidhur midis tij dhe paditësit më datë 22.6.2001.

Gjykata e shkallës së parë, pasi konstatoi se kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë dhe se, përsa i përket formës, përmbush kërkesat e paragrafit të II-të të nenit 160 të Kodit të Procedurës Civile, më 17.01.2003 mori vendim të ndërmjetëm, me të cilin u vendos që ajo të gjykohej së bashku me padinë dhe shtyu seancën, duke i dhënë kështu kohë paditësit për t'u njohur me përmbajtjen e saj dhe provat shkresore bashkëlidhur. Mbas tetë seancave gjyqësore, zhvilluar, si rreth kërkimeve të padisë, ashtu edhe atyre të kundërpadisë, në seancën e datës 20.4.2003, gjykata, në zbatim të nenit 178 të Kodit të Procedurës Civile, mori vendim të ndërmjetëm dhe largoi nga salla e gjyqit, paditësin e k/paditur, për prishje të rregullit e qetësisë, duke theksuar se gjykimi do të vazhdonte në prani të av.Manushaqe Zhulali, caktuar, si përfaqësuese, me prokurë të posaçme prej tij. Ajo kishte marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore që ishin zhvilluar deri atëherë. Meqenëse, edhe pas largimit të klientit të saj, gjykata vazhdoi me pyetjen e dëshmitarit Leonard Lama, (i cili ishte sjellë nga i padituri - k/paditës), pa dhënë sqarime për shkakun, u largua nga salla edhe përfaqësuesja e paditësit të k/paditur. Menjëherë mbas kësaj, gjykata mori vendim të ndërmjetëm (që e bazoi në nenet 179 dhe 299/c të Kodit të Procedurës Civile), për pushimin e gjykimit, përsa i përket padisë dhe vazhdimin e tij, për k/padinë dhe, pasi mori vendim për administrimin e provave shkresore, i dha fund shqyrtimit gjyqësor dhe kaloi në dëgjimin e pretendimeve të fundit të palëve. Me kërkesën, për kohë për përgatitje të të paditurit - k/paditës, gjykata, në prani vetëm të këtij të fundit, shtyu seancën, për më 2.5.2003, seancë që u zhvillua duke mos qenë të pranishëm as paditësi - i k/paditur, as përfaqësuesja e tij. Veç këtij fakti (të mosqenies të pranishëm të këtyre të fundit), nga aktet, nuk rezulton që ata të jenë njoftuar për datën dhe orën e seancës pasardhëse (datë 2.5.2003). Figuron gjithashtu sikur ishte marrë vendimi i mungesës për këtë palë, vendim ky që, pavarësisht se nuk do të ndryshonte asgjë lidhur me parregullsinë e njoftimeve, sikundër del nga aktet, nuk rezulton që të jetë marrë as në seancën e mëparshme, as në seancën e fundit, datë 2.5.2003, në të cilën u mor edhe vendimi përfundimtar nr.1896. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.718, datë 4.6.2006, të saj.

Duke pasur parasysh parashtrimin e fakteve si më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arritën në përfundimin se, si vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe ai i apelit, janë marrë duke mos u përmbushur kërkesat e ligjit procedural civil dhe, për rrjedhojë, ato duhet të prishen, si për shkaqe që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së pjesëmarrësve në proces, (në rastin konkret të paditësit - të k/paditur), kusht ky i domosdoshëm për të pasur një proces të rregullt ligjor (neni 131/f i Kushtetutës), ashtu edhe për moszbatimin e kërkesave të dispozitave procedurale rreth pushimit të gjykimit (neni 299 i Kodit të Procedurës Civile).

Përsa i përket parregullsive që u lejuan gjatë zhvillimit të procesit civil midis këtyre palëve, ato kanë të bëjnë me mosrespektimin e normave procedurale civile në lidhje me njoftimet, (në rastin konkret, të paditësit - të k/paditur) për datën dhe orën që ishte caktuar nga gjykata e shkallës së parë në të cilën, me vendimin e ndërmjetëm të datës 30.4.2003, ishte caktuar se do të zhvillohej seanca gjyqësore pasardhëse. Megjithatë vetë gjykata, në këtë vendim shprehet për shtyrjen e seancës për datën 2.5.2004, **për t'u dhënë kohë palëve** që të përgatishnin pretendimet e fundit, njëherë prej këtyre palëve dhe konkretisht, paditësin e k/paditur dhe përfaqësuesen e tij, (të cilët - i pari se ishte nxjerrë prej vetë gjykatës nga salla e gjyqit, kurse e dyta, se, në vijim të mbajtjes së linjës së respektimit të interesave të klientit të vet, u largua pa pritur përfundimin e asaj seance), në kundërshtim me urdhërimin e parashikuar në dispozitën e nenit 18 të Kodit të Procedurës Civile, nuk e njoftoi për zhvillimin e seancës së ardhshme, jo vetëm duke mos respektuar, në këtë mënyrë, një nga parimet kryesore në të cilat bazohet procesi gjyqësor civil sikundër është ai i kontradiktoritetit, (nenet 20 - 21 të Kodit të Procedurës Civile), por duke e vënë atë në pozita inferioriteti në raport me palën tjetër në favor të së cilës edhe u vendos, përfundimisht, prej saj, (gjykatës).

Përsa i përket shkakut tjetër - moszbatimit prej gjykatës së shkallës së parë të kërkesave procedurale në lidhje me pushimin e gjykimit, në rastin konkret vetëm për padinë që kishte paraqitur paditësi - i k/paditur, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësojnë se, trajtimi i tij në këtë vendim duhet bërë në funksion të njësimit të praktikës gjyqësore që është edhe motivimi i ardhjes, me vendimin e datës 14.7.2005, të Kodit Civil të saj, të kësaj çështjeje në këto Kolegje, vendim në të cilin janë parashtruar, sikundër u përmend në pjesën hyrëse, momentet për të cilat kërkohet të bëhet njësimi i praktikës gjyqësore. Thelbësore, prej këtyre momenteve, është ai që ka lidhje me fatin që do të ketë gjykimi i k/padisë në rastet e pushimit të gjykimit të padisë, së paraqitur nga paditësi sikurse në rastin konkret, nga shtetasi Naim Elezi, ndaj të cilit i padituri shoqëria tregtare "MASGLASS," -sh.p.k. i është kundërtuar me k/padi që përmban kërkimin e formuluar në pjesën e kërkit të objektit të saj.

Në trajtimin e momenteve të njësimit të praktikës gjyqësore lidhur me kundërpadinë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete civile objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, marrin për bazë dhe konfirmojnë edhe njëherë sa janë trajtuar dhe njësuar në lidhje po me kundërpadinë, si institut i veçantë i së drejtës procedurale civile, në vendimin nr.101, datë 21.6.2000, unifikues të tyre.

Në vijim çmojnë se, sa parashtrohet në vendimin e tanishëm duhet konsideruar vazhdim i vendimit të mëparshëm të tyre në të cilin është trajtuar gjerësisht, jo vetëm natyra juridike e kundërpadisë dhe forma e kufizimit në lidhje me momentin procedural në të cilin ajo mund të paraqitet në një proces gjyqësor civil të filluar tashmë, por edhe konsiderimi i saj si padi më vete, e cila mund të paraqitet në një gjykim të veçantë nga ai i filluar më parë për gjykimin e një padie, për shkak koneksiteti, i cili qëndron pikërisht në lidhjen që ekziston midis kërtimeve të njëra-tjetrës apo se ndodhemi para rastit kur, midis palëve mund të bëhet ndërshtyerje e ndërsjellë detyrimesh.

Në vendimin e mëparshëm të këtyre Kolegjeve, duke u konsideruar, si padia, ashtu edhe k/padia, si padi më vete, përcaktohet se, kur ato gjykohen së bashku, në një gjykim të vetëm, (sikundër filloi gjykimi i tyre në çështjen objekt gjykimi), me vendimin përfundimtar, sipas rastit, mund të vendoset: a) Pranimi i padisë dhe i k/padisë, duke vendosur, kur është rasti, edhe ndërshtyerjen e detyrimeve të ndërsjella; b) Pranimi i padisë dhe rrëzimi i k/padisë; c) Rrëzimi i padisë dhe pranimi i k/padisë dhe ç) Rrëzimi si i padisë, ashtu edhe i k/padisë. Ajo që, në vazhdim të sa u përmendën, mbetet për t'u njësuar, për shkak se përbën objekt në çështjen civile objekt gjykimi në Kolegjet e Bashkuara në gjykimin e tanishëm, si dhe, sepse konstatohen kundërshti në disa vendime të Kodit Civil (shih vendimet nr.578, datë 13.7.1999; nr.203, datë 21.1.2000 dhe nr.761, datë 8.4.2004), ka të bëjë me rastet kur për shkakun para të cilit ndodhet gjykata, rast pas rasti, në një gjykim të përbashkët të padisë me k/padinë, vendoset pushimi i gjykimit të padisë, cili do të jetë fati i gjykimit të k/padisë, të bashkuar tashmë. Bashkë me pushimin e gjykimit të padisë, do të vendoset edhe pushimi i gjykimit

të k/padisë, apo ky i fundit mund të vazhdojë në fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi gjyqësor i çështjes në momentin e pushimit të gjykimit të padisë dhe në përfundim të tij, gjykata, në një vendim të vetëm, të shprehet, si për kërkimet e paditësit, ashtu edhe për ato të kundërpaditësit?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në sa u parashtruan, arritën në përfundimin unifikues sipas të cilit **në një gjykim, në të cilin është pranuar që bashkë me gjykimin e padisë të zhvillohet edhe gjykimi i k/padisë, pushimi i gjykimit të padisë, pavarësisht nga shkaku, nuk passjell, vetvetiu, edhe pushimin e gjykimit të k/padisë. Përkundrazi, gjykimi i k/padisë mund të vazhdojë normalisht dhe gjykata, në vendimin përfundimtar, duhet të shprehet, si për kërkimet e padisë, ashtu edhe për ato të kundërpadisë, sikurse ato të ishin gjykuar më vete, në dy gjykime të veçanta.** Arritën gjithashtu edhe në përfundimin se, (veç interesit praktik të drejtësisë për sigurimin e kushteve optimale për një ekonomi efektive gjyqësore dhe interesit vetiak të k/paditësit për mosplotësimin, për shkaqe që nuk varen nga ai, të afateve të parashkrimit të k/padisë, nëse ajo do të paraqitej si padi në një proces gjyqësor më vete), **në këto raste, është i padituri - k/paditës subjekti procedural, i cili ka të drejtën për të disponuar lidhur me faktin nëse dëshiron ose jo vazhdimin e gjykimit të k/padisë edhe mbas pushimit të gjykimit të padisë, vullnet, të cilin, në çështjen objekt gjykimi, i padituri - k/paditës e realizoi nëpërmjet përgjigjes pozitive që i dha pyetjes së gjykatës pas marrjes prej saj të vendimit të ndërmjetëm për pushimin e gjykimit të padisë. Fakti që, fillimisht, gjykata u vu në lëvizje nga paditësi, nëpërmjet paraqitjes para saj të kërkesëpadisë, nuk përbën shkak të arsyeshëm për mosvazhdimin e një gjykimi tashmë në zhvillim e sipër; vazhdim që, në rastin e bashkimit në një gjykim të vetëm edhe të k/padisë nënkupton, në mënyrë të pazgjydhshme, krahas iniciativës fillestare të paditësit nga njëra anë, edhe iniciativën e kundërpaditësit për përmasat procedurale brenda dhe rreth të cilave mund të vazhdojë të jetë në lëvizje (rrjedhën) një proces civil, objektin e të cilit e përbëjnë jo më një, por dy padi më vete, ndonëse në role të ndryshuara (të alternuara), por me po ata persona si palë ndërgjyqëse, nga ana tjetër.**

Përveç sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara konstatuan se, në çështjen objekt gjykimi, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka gabuar edhe në lidhje me vetë vendimin e ndërmjetëm të datës 30.4.2003 për pushimin e gjykimit të padisë, pasi ai është marrë pa qenë e pranishme asnjëra prej rrethanave që parashikohen në dispozitën e nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile.

Me këtë rast, ato vlerësojnë se, **as largimi, në zbatim të nenit 178 të Kodit të Procedurës Civile, prej gjykatës, i paditësit, as edhe lënia e sallës së gjyqit, qoftë dhe pa sqarimet e rastit, nga përfaqësuesja e tij, nuk mund të konsiderohen heqje dorë nga gjykimi i padisë (neni 299/b i Kodit të Procedurës Civile) apo mosparaqitje e palëve, në kuptimin procedural që, sipas përmbajtjes së dispozitave të neneve 175 e 179 të Kodit të Procedurës Civile në fuqi, ka termi "mosparaqitja e palëve" në procesin civil.**

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, konstatimi i të metave që u vunë në dukje përsa i përket gjykimit të kësaj çështjeje konkrete civile dhe përcaktimet unifikuese që u dhanë prej tyre në lidhje me interpretimin e kuptimit të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, nga njëra anë, do të ndihmojnë gjykatën që do të rigjykojë çështjen për zgjidhjen e drejtë, të bazuar në ligj e në prova të saj dhe, nga ana tjetër, do të shërbejnë edhe për gjykatat e tjera për të zbatuar në mënyrë të unifikuar, këto dispozita gjatë zgjidhjes së çështjeve të ngjashme, në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 481 dhe 485/"ç" të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.1896, datë 2.5.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr.718, datë 4.6.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes, për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me trup gjykues tjetër.

2. Ky vendim është unifikues. Një kopje e tij të dërgohet, për botim, në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.7, datë 21.3.2006

PËR MJAFTUESHMËRINË E PROVIGJONEVE TEKNIKE E MATEMATIKE TË
SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Në mbështetje të shkronjave “i” dhe “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, nenit 101 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, rregullores nr.2, datë 22.12.2004 “Mbi bazat, metodat dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jojetës” edhe rregullores nr.8, datë 22.12.2004 “Mbi bazat, metodat dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike” të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë të mjaftueshme provigjionet teknike e matematike të datës 31.12.2005 të përlogaritura nga shoqëritë INSIG sh.a., SIGMA sh.a., SIGAL sh.a., ATLANTIK sh.a., INTERSIG sh.a., ALBSIG sh.a. dhe SIGAL LIFE sh.a., sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të konsiderojë të mjaftueshme provigjionet teknike të datës 31.12.2005 të përlogaritura nga sektori i aktuaristikës së Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve për shoqëritë INTERALBANIAN, sh.a., DUKAGJINI AL sh.a., dhe SICRED sh.a., sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shoqëritë e sigurimit INTERALBANIAN sh.a., DUKAGJINI AL sh.a., dhe SICRED sh.a., të zbatojnë provigjionet teknike të përlogaritura nga sektori i aktuaristikës të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Shoqëritë e sigurimit të pasqyrojnë provigjionet teknike dhe matematike në pasqyrat financiare në formën bruto me risigurimet, si dhe pjesën e risiguresit në provigjionet teknike sipas kërkesave të udhëzimit nr.1, datë 22.12.2004 të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

5. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe e inspektimit për të verifikuar aktivet dhe drejtimet e investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera

ANEKS

PROVIGJONET TEKNIKE E MATEMATIKE (NETO NGA RISIGURIMET) MË 31.12.2005 PËR
SHOQËRITË E SIGURIMIT

INSIG JOJETË	1.692.336.344 lekë
INSIG JETË	69.256.435 lekë
SIGMA	730.295.009 lekë
SIGAL	998.941.990 lekë
ATLANTIK	249.783.140 lekë
INTERSIG	150.382.604 lekë
INTERALBANIAN	90.277.817 lekë
DUKAGJINI AL	25.983.473 lekë

ALBSIG	91.880.785 lekë
SICRED	29.213.303 lekë
SIGAL LIFE	39.265.885 lekë

PJESA E RISIGURUESIT NË PROVIGJONET TEKNIKE E MATEMATIKE MË 31.12.2005

INSIG JOJETË	599.115.350 lekë
INSIG JETË	7.384.058 lekë
SIGMA	50.870.700 lekë
SIGAL	81.525.403 lekë
ATLANTIK	
INTERSIG	
INTERALBANIAN	3.399.789 lekë
DUKAGJINI AL	
ALBSIG	
SICRED	7.166.556 lekë
SIGAL LIFE	

VENDIM

Nr.8, datë 21.3.2006

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE NR.1, DATË 22.12.2004 “PËR LISTËN E DOKUMENTEVE TË LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE DHE PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”

Në mbështetje të shkronjave “i” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, me propozim të Drejtorisë së Analizës Financiare dhe Aktuaristikës, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1.Të miratojë udhëzimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.1, datë 22.12.2004 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Të njoftohen të gjitha shoqëritë e sigurimit për këto ndryshime.
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera**

UDHËZIM
Nr.1, datë 21.3.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E AUTORITETIT MBIKËQYRËS
TË SIGURIMEVE NR.1, DATË 22.12.2004 “PËR LISTËN E DOKUMENTEVE TË
LLOGARIDHËNIES SË DETYRUAR VJETORE DHE PERIODIKE TË SHOQËRIVE TË
SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”**

Në mbështetje të shkronjës “i” dhe “k” të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbiqëqyrës të Sigurimeve” dhe nenit 115 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Autoriteti Mbiqëqyrës i Sigurimeve

UDHËZON:

1. Tabelat M-1D, M-5D, M-1P dhe M-5P të udhëzimit nr.1, datë 22.12.2004 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit” të ndryshojnë sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në udhëzimin nr.1, datë 22.12.2004 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore dhe periodike të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit” shtohen tabelat M-2/A, M-2/B, M-4/A dhe M-4/B sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Pas seksionit Pasqyra “Informacion për dëmet me vlera të mëdha” në fund të udhëzimit, shtohet një pikë me përmbajtjen si vijon:

“Shoqëritë e sigurimit raportojnë në Autoritetin Mbiqëqyrës të Sigurimeve në mënyrë të detajuar për policat e shitura, si dhe për dëmet e paguara dhe ato pezull për çdo klasë sigurimi çdo datë 15 të muajit pasardhës në mënyrë elektronike.

Me të dhëna të detajuara për policat e shitura kuptohet:

- a) numri serial i policës;
- b) emri i të siguruarit;
- c) data e nënshkrimit, data e fillimit, data e mbarimit të policës së sigurimit;
- d) kategoria e mjetit motorik, në rastin e sigurimit të mjeteve motorike;
- e) targa dhe nr.i shasisë;
- f) primi i pastër dhe shpenzimet që i shtohen;
- g) dega e shoqërisë e cila ka nënshkruar.

Me të dhëna të detajuara për dëmet e paguara ose pezull do të kuptohet:

- a) seria e policës së sigurimit për të cilën është paguar dëmshpërblimi;
- b) vlera e dëmit të kërkuar nga i siguruari;
- d) vlera e dëmit të paguar dhe data në të cilën është bërë pagesa nga shoqëria e sigurimit;
- e) statusi i praktikës së dëmit (nëse është pezull, e paguar ose praktike e mbyllur);
- f) provigjoni teknik;
- g) të dhëna mbi pjesën e risiguruesit në provigjонin e dëmit për çdo vlerësim
- h) data kur ka ndodhur ngjarja e siguruar.

4. Të gjitha shoqëritë e sigurimit të fillojnë raportimin në përputhje me këto ndryshime në muajin prill 2006.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera**

SHOQERIA _____							
	PASQYRA PER KONTRATAT E SIGURIMIT Kartoni Jeshil TE MUAJIT _____						
							Tabela M - 4/A
Kl	Lloji i Produktit	Gjendja ne fillim		Furnizimi		Gjendja ne fund	
		Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)
		1	2	3	4	5	6
I	15 ditore						
II	1 mujore						
III	2 mujore						
IV	3 mujore						
V	4 mujore						
VI	5 mujore						
VII	6 mujore						
VIII	7 mujore						
IX	8 mujore						
X	9 mujore						
XI	10 mujore						
XII	Vjetore						
	TOTALI (I - XII)						
<i>Shenim: kjo tabele plotesohet nga shoqeria per cdo furnizim te bere nga BSSH, dhe raportohet prane Autoritetit brend dates15 te muajit pasardhes</i>							

SHOQERIA _____

PASQYRA PER KONTRATAT E SIGURIMIT Kartoni Jeshil TE MUAJIT _____

Dega _____

Tabela M - 4/B

KI	Lloji i Produktit	Gjendja ne fillim		Furnizimi		Gjendja ne fund	
		Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)
		1	2	3	4	5	6
I	15 ditore						
II	1 mujore						
III	2 mujore						
IV	3 mujore						
V	4 mujore						
VI	5 mujore						
VII	6 mujore						
VIII	7 mujore						

IX	8 mujore						
X	9 mujore						
XI	10 mujore						
XII	Vjetore						
	TOTALI (I - XII)						

Shenim: kjo tabele plotesohet nga dega e shogerise per cdo furnizim te bere nga drejtoria e pergjithshme, dhe raportohet prane Autoritetit brend dates15 te muajit pasardhes

SHOQERIA _____

AKTIVITETI I JETES

PASQYRA E DEMEVE TE Periudhes _____

Tabela M - 5D

KI	Lloji i produktit	Deme pezull(nga demet e ndodhura gjate vitit_____)				Deme pezull(nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme_____)				Deme te paguara(nga demet e ndodhura gjate vitit_____)				Deme te paguara(nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme_____)				Pjesa e Risiguruesit ne Deme					
		nga demet e ndodhura gjate vitit_____)				nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme_____)				nga demet e ndodhura gjate vitit_____)				nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme_____)				nga demet e ndodhura gjate vitit_____)			nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme		
		Nr.	000/Leke	USD	EURO	Nr.	000/Leke	USD	EURO	Nr.	000/Leke	USD	EURO	Nr.	000/Leke	USD	EURO	000/Leke	USD	EURO	000/Leke	USD	EURO
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
	SIG. JETES																						
1	Jete - Vdekje																						
2	Kreditore																						
3	Nxenesi e Studenti																						
4	Depozitori																						
5	Jeta ne Grup																						
6	Jete e Kombinuar																						
7	Jeta me Kursim																						
8	Jeta me Studentin																						
9	Jeta me Udhartet																						
10	Martese - Lindje																						
11	Sig qe lidhen me fond investimi																						
12	Administrimi i Fondeve Kolektive																						
	TOTALI																						

SHOQERIA _____

AKTIVITETI I JO- JETES

PASQYRA E DEMEVE TE Periudhes _____

Tabela M - 1D

KI	Lloji i produktit	Deme pezull(nga demet e ndodhura gjate vitit_____)				Deme pezull (nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme_____)				Deme te paguara(nga demet e ndodhura gjate vitit_____)				Deme te paguara(nga demet e ndodhura ne vitet e mepareshme_____)				Pjesa e Risiguruesit ne Deme					
		Nr. 1	000/ Leke 2	USD 3	EURO 4	Nr. 5	000/ Leke 6	USD 7	EURO 8	Nr. 9	000/ Leke 10	USD 11	EURO 12	Nr. 13	000/ Leke 14	USD 15	EURO 16	000/ Leke 17	USD 18	EURO 19	000/ Leke 20	USD 21	EURO 22
A	Sig aksid dhe shend																						
A1	Sig aksidenteve																						
A2	Sig shendetit																						
A3	Sig i detyruar i udhetareve																						
B	Sig Motorrike																						
B1	Sig.i vete mjet.motorrik (Kasko)																						
B2	TPL																						
B3	Karton jeshil																						
B4	Provizore																						
B5	Kufitare																						
C	Sig Marines																						
C1	Anijet																						
C2	Pergjegjesi civile anije																						
D	Sig Avioneve																						
D1	Avionet																						
D2	Pergjegjesi civile avionet																						
E	Zjarri e demtimet ne prone																						
E1	Zjarri dhe rreziket shtese																						
E2	Vjedhje																						
E3	Bujqesi e blegtori																						
E4	Pasuri te tjera																						
F	Mallrat ne transport																						

F1	Mallra ne transport nga anijet																						
F2	Mallra ne transport nga Avionet																						
F3	Mallra ne transport te tjera																						
G	Sig Pergjegjesive																						
G.1	Sig i pergjegjesive																						
G.2	Inxhinierike																						
H	Sig Kreditit																						
H.1	Rreziku i paafesise pagueese																						
H.2	Kredite e eksportit																						
H.3	Kredite me keste																						
H.4	Kredite hipotekare																						
H.5	Kredi bujqesore																						
H.6	Kredi te tjera																						
I	Sig Garancive																						
I.1	Sigurimi i garancive																						
I.2	Sigurim garanci oferte																						
I.3	sigurim garanci kontrate																						
J	Mjete qe levizin mbi shina																						
K	Sig.i humbjeve financiare																						
	TOTALI																						

SHOQERIA _____

AKTIVITETI I JETES

PASQYRA E PRIMEVE TE SIGURIMIT TE Muajit _____ (Progresive)

Tabela M - 5P

KI	Lloji i Produktit	Numri i kontr. lidhura	PRIME TE SHKRUARA BRUTO				PRIME TE CEDUARA NE RISIGURIM		
			TOTAL 000/Leke	000/Leke	USD	EURO	TOTAL 000/Leke	USD	EURO
		1	2	3	4	5	6	7	8
	SIG. JETES								
1	Jete - Vdekje								
2	Kreditori								
3	Nxenesi e Studenti								
4	Depozitori								
5	Jeta ne Grup								
6	Jete e Kombinuar								
7	Jeta me Kursim								
8	Jeta me Studentin								
9	Jeta me Udhetares								
10	Martese - Lindje								
11	Sig qe lidhen me fond investimi								
12	Administrimi i Fondeve Kolektive								
	TOTALI								

Shenim: Termi Prime te shkruara Bruto nenkupton primet e shkruar duke perfshire dhe vleren e primeve te ceduar ne risigurim

Shenim: kjo tabelë raportohet prane Autoritetit brenda dates 15 te muajit pasardhes

SHOQERIA _____

AKTIVITETI I JETES

PASQYRA E PRIMEVE TE SIGURIMIT TE Muajit _____ (Mujore)

Tabela M - 5P

KI	Lloji i Produktit	Numri i kontr. lidhura	PRIME TE SHKRUARA BRUTO				PRIME TE CEDUARA NE RISIGURIM		
			TOTAL 000/Leke	000/Leke	USD	EURO	TOTAL 000/Leke	USD	EURO
		1	2	3	4	5	6	7	8
	SIG. JETES								
1	Jete - Vdekje								
2	Kreditori								
3	Nxenesi e Studenti								
4	Depozitori								
5	Jeta ne Grup								
6	Jete e Kombinuar								
7	Jeta me Kursim								
8	Jeta me Studentin								
9	Jeta me Udhetares								
10	Martese - Lindje								
11	Sig qe lidhen me fond investimi								
12	Administrimi i Fondeve Kolektive								
	TOTALI								

Shenim: Termi Prime te shkruara Bruto nenkupton primet e shkruar duke perfshire dhe vleren e primeve te ceduar ne risigurim

SHOQERIA _____

AKTIVITETI I JO-JETES

PASQYRA E PRIMEVE TE SIGURIMIT TE Muajit _____ (Mujore)

Tabela M - 1P

KI	Lloji i Produktit	Numri i kontr. lidhura	PRIME TE SHKRUARA BRUTO				PRIME TE CEDUARA NE RISIGURIM		
			TOTAL 000/Leke	000/Leke	USD	EURO	TOTAL 000/Leke	USD	EURO
		1	2	3	4	5	6	7	8
A	Sig aksid dhe shend								
A1	Sig aksidenteve								
A2	Sig shendetit								
A3	Sig i detyruar i udhetareve								
B	Sig Motorrike								
B1	Sig.i vete mjet.motorrik (Kasko)								
B2	TPL								
B3	Karton jeshil								
B5	Kufitare								
C	Sig Marines								
C1	Anijet								
C2	Pergjegjesi civile anije								
D	Sig Avioneve								
D1	Avionet								
D2	Pergjegjesi civile avionet								
E	Zjarri e demtimet ne prone								
E1	Zjarri dhe rreziket shtese								
E2	Vjedhje								
E3	Bujqesi e blegtori								
E4	Pasuri te tjera								
F	Mallrat ne transport								
F1	Mallra ne transport nga anijet								
F2	Mallra ne transport nga Avionet								
F3	Mallra ne transport te tjera								
G	Sig Pergjegjesive								
G.1	Sig i pergjegjesive								
G.2	Inxhinierike								
H	Sig Kreditit								
H.1	Rreziku i paaftesise paguese								
H.2	Kredite e eksportit								
H.3	Kredite me keste								
H.4	Kredite hipotekare								
H.5	Kredi bujqesore								
H.6	Kredi te tjera								
I	Sig Garancive								
I.1	Sigurimi i garancive								
I.2	Sigurim garanci oferte								
I.3	sigurim garanci kontrate								
J	Mjete qe levizin mbi shina								
K	Sig.i humbjeve financiare								
	TOTALI								

Shenim: Termi Prime te shkruara Bruto nenkupton primet e shkruar duke perfshire dhe vleren e primeve te ceduar ne risigurim

Shenim: kjo tabelë raportohet prane Autoritetit brenda dates15 te muajit pasardhes

SHOQERIA _____

AKTIVITETI I JO-JETES

PASQYRA E PRIMEVE TE SIGURIMIT TE Muajit _____ (Progresive)

Tabela M - 1P

KI	Lloji i Produktit	Numri i kontr. lidhura	PRIME TE SHKRUARA BRUTO				PRIME TE CEDUARA NE RISIGURIM	
			TOTAL 000/Leke	000/Leke	USD	EURO	TOTAL 000/Leke	USD
		1	2	3	4	5	6	7
A	Sig aksid dhe shend							
A1	Sig aksidenteve							
A2	Sig shendetit							
A3	Sig i detyruar i udhetareve							
B	Sig Motorrike							
B1	Sig.i vete mjet.motorrik (Kasko)							
B2	TPL							
B3	Karton jeshil							
B5	Kufitare							
C	Sig Marines							
C1	Anijet							
C2	Pergjegjesi civile anije							
D	Sig Avioneve							
D1	Avionet							
D2	Pergjegjesi civile avionet							
E	Zjarri e demtimet ne prone							
E1	Zjarri dhe rreziket shtese							
E2	Vjedhje							
E3	Bujqesi e blegtori							
E4	Pasuri te tjera							
F	Mallrat ne transport							
F1	Mallra ne transport nga anijet							
F2	Mallra ne transport nga Avionet							
F3	Mallra ne transport te tjera							
G	Sig Pergjegjesive							
G.1	Sig i pergjegjesive							
G.2	Inxhinierike							
H	Sig Kreditit							
H.1	Rreziku i paaftesise paguese							
H.2	Kredite e eksportit							
H.3	Kredite me keste							
H.4	Kredite hipotekare							
H.5	Kredi bujqesore							
H.6	Kredi te tjera							
I	Sig Garancive							
I.1	Sigurimi i garancive							
I.2	Sigurim garanci oferte							
I.3	sigurim garanci kontrate							
J	Mjete qe levizin mbi shina							
K	Sig.i humbjeve financiare							
	TOTALI							

Shenim: Termi Prime te shkruara Bruto nenkupton primet e shkruar duke perfshire dhe vleren e primeve te ceduar ne risigurim

Shenim: kjo tabelë raportohet prane Autoritetit brenda dates15 te muajit pasardhes

SHOQERIA _____

PASQYRA PER KONTRATAT E SIGURIMIT TPL TE MUAJIT _____

Tabela M - 2/A

KI	Lloji i Produktit	Gjendja ne fillim		Furnizimi		Gjendja ne fund	
		Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)
		1	2	3	4	5	6
A	Motociklete						
B1	Autoveture						
B2	Furgon						
C1	Autobuz						
D1	Kamioncine						
D2	Kamion						
E	Rimorkio						
F	Mjete bujqesore						
G	Zjarrfikse						
	TOTALI I						

Shenim: kjo tabelë plotësohet nga shoqëria për çdo furnizim të bërë nga BSSH, dhe raportohet pranë Autoritetit brenda 15 ditëve të muajit pasardhës

SHOQERIA _____

PASQYRA PER KONTRATAT E SIGURIMIT TPL TE MUAJIT _____

Dega _____

Tabela M - 2/B

Kl	Lloji i Produktit	Gjendja ne fillim		Furnizimi		Gjendja ne fund	
		Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)	Nr	Seria (nga-deri ne)
		1	2	3	4	5	6
A	Motociklete						
B1	Autoveture						
B2	Furgon						
C1	Autobuz						
D1	Kamioncine						
D2	Kamion						
E	Rimorkio						
F	Mjete bujqesore						
G	Zjarrfikse						
	TOTALI I						

Shenim: kjo tabelë plotësohet nga dega e shoqërisë për çdo furnizim të bërë nga drejtoria e përgjithshme, dhe raportohet pranë Autoritetit brend 15 të muajit pasardhës

VENDIM
Nr.24, datë 12.04.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa d të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “G.S.A” sh.p.k., për licencimin e aktivitetit të eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë “G.S.A” sh.p.k. për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “G.S.A” sh.p.k., konform rregullores për procedurat e licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjeter Dema

VENDIM
Nr.25, datë 12.04.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Maksi Elektrik sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2005,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë Maksi Elektrik sh.p.k.

2. Ngarkohet Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria Maksi Elektrik sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjeter Dema

VENDIM
Nr.26 , datë 12.04.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Essegei Shqipëri Smokthina sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2006,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë Essegei Shqipëri Smokthina sh.p.k.

2. Ngarkohet Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria Essegei Shqipëri Smokthina sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjeter Dema

KËRKESË

Shtetësja Suzana Muka, banuese në komunën Golem, rrethi Kavajë, kërkon deklarinimin e vdekjes së shtetasit Arben Muka dhe përcaktimin e trashëgimtarëve të tij ligjorë.

Kërkuese
Suzana Muka

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

U dorëzua për shtyp më 19.4.2006

Doli nga shtypi më 24.4.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë